



01 Nr. 047/26 Dt. 30.01.2026



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Në bazë të nenit 13 dhe 58 të Ligjit nr. 03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28/2008) dhe nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit nr. 01/011-5643 të datës 15.10.2008, pas kërkesës së Drejtorisë së Shërbimeve Publike, kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M Për formimin e Grupit Punues

- Formohet dhe emërohet Grupi Punues për hartimin e Draft Rregullores për plotësimin dhe ndryshimin e Rregullores nr. 01/2022 për Menaxhimin e Mbeturinave në Komunën e Prizrenit, e cila është plotësuar dhe ndryshuar me Rregulloren (KPZ) për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores nr. 001-011-38749, datë 10.03.2022. Anëtarë të këtij Grupi Punues, emërohen:
 - Muhamet Bajrami kryesues,
 - Islam Osmankaj anëtar,
 - Halil Likajanëtar,
 - Florentina Çoçaj Hoti,..... anëtare,
 - OJQ "Ec Ma Ndryshe".....anëtar,
 - Haziz Krasniqi,anëtar,
 - Besarta Cakaj,.....anëtare.
 - Detyrat e Grupit Punues, të emëruar si në pikën 1 të këtij Vendimi është që në afat sa më të shkurtër kohor të hartojë Draft Rregulloren për plotësimin dhe ndryshimin e Rregullores nr. 01/2022 për Menaxhimin e Mbeturinave në Komunën e Prizrenit, e cila është plotësuar dhe ndryshuar me Rregulloren (KPZ) për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores nr. 001-011-38749, datë 10.03.2022, në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi, dhe pas hartimit të draftit përkatës, ta procedojë atë në organet kompetente për shqyrtim dhe miratim.
 - Këshillë Juridike:** Kundër këtij Vendimi, pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës në Shërbimin Civil, në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi.
 - Obligohet Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Grupi Punues për zbatimin e këtij vendimi.
 - Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e nënshkrimit të tij.
- Vendimi iu dërgohet:
- Drejtorisë së Shërbimeve Publike,
 - Të emëruarve,
 - Arkivës së Kryetarit.

Kryetari i Komunës
Shaqir Totaj